

Frymëzime Predikimi

për të dielat e muajit shtator 2020

E diela e I

Ez 33, 1-7-9; Ps 94 (Oh sikur ta ndienit sot zërin e tij); Rom 13, 8-10; Mt 18, 15-20

Dëgjoni. Kjo është parulla jonë për sot. Duhet të dëgjojmë pa e ngurtësuar zemrën, na kujton psalmi. Nuk mjafton të dëgjojmë atë që thuhet, duhet ta lëmë veten të vihemi në lëvizje, ta lëmë veten që të shndërrohemi prej fjalëve të shqiptuara. Para së gjithash, prej fjalëve të Zotit që është Krijuesi ynë, Ai që ka plazmuar krejt tokën.

Çfarë na thuhet? Që ta duam njëri-tjetrin, që ta dëgjojmë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë. Këtë vënë në dukje rreshtat e Letrës drejtuar Romakëve dhe pjesa e Ungjillit. Sot, në kohët e ndryshimeve klimaterike, është e nevojshme që të përfshijmë në dashurinë tonë dhe në dëgjimin tonë jo vetëm qeniet njerëzore, por krejt krijimin.

Cila është detyra jonë si Kishë? Na e mëson profeti. Jemi të thirrur që të jemi rojtarë dhe e kemi për detyrë që t'u bëjmë të ditur të tjerëve se jemi me të vërtetë në rrezik, se jeta jonë dhe e krejt krijimit është e kërcënuar. E kërcënuar prej stileve tona të jetës, që konsumojnë burimet e të mirave të përbashkëta, në vend që t'i bashkëndajnë ato, dhe që ndotin e shkatërrojnë tokën, në vend që të kujdesen për të.

Do të jemi rojtarë më bindës, nëse ne vetë praktikojmë stile jete që e ruajnë krijimin.

PASTORJA DOROTHEE MACK
(KISHA VALDEZE)

E diela e II

Sir 27, 30 - 28, 7, NV 27, 33 - 28, 9; Ps 102 (Zoti është i mirë e i mëshirshëm); Rom 14, 7-9; Mt 18, 21-35

“Zotëri, nëse vëllai im gabon ndaj meje, sa herë duhet ta fal? Deri në shtatë herë?”.

Zotëria i shëmbëlltyrës ungjillore pati mëshirë për shërbëtorin, i cili duhej t'i kthente atij një shifër shumë të lartë, dhe ia fali borxhin, por shërbëtori mendoi vetëm për vete dhe nuk bëri të njëjtën gjë edhe ai. Na pëlqen apo jo, nuk jetojmë vetëm dhe për veten tonë (Leximi II), por në një kontekst social më të gjerë, ku gabimi im ndikon mbi njerëzimin dhe krejt krijimin. Është e nevojshme që të bëhemi të vetëdijshëm për ndërlindjen jetësore që ekziston mes nesh, sepse *“mungon vetëdija e një zanafille të përbashkët, e një përkatësie të përbashkët dhe e një të ardhmeje të bashkëndarë prej të gjithëve”* (Laudato si', nr. 206).

Për këtë arsye, të bësh përvojën e faljes së Hyjit, duke njohur shenjat e dashurisë së Tij – që ekziston në shekuj të shekujve (shih psalmin) – na shtyn që t'i dëgjojmë me kujdes nevojat e tjetrit, por që ta dëgjojmë edhe britmën e tokës me zemër të ripërtërirë. Vetëm kështu mund të lindin qëndrime dhe stile jete që respektojnë njeriun dhe mjedisin, duke e parë veten si pjesë të këtij krijimi, ku gjithçka është në marrëdhënie, gjithçka është e lidhur.

GLORIA MARI
(SHOQATA NOCETUM)

E diela e III

Is 55, 6-9; Ps 144 (Zoti është afër të gjithë atyre që e thërrasin); Fil 1, 20c-24.27a; Mt 20, 1-16

“Sepse, sikurse qielli që është i lartë në krahasim me tokën: po ashtu edhe udhët e mia janë të larta në krahasim me udhët tuaja dhe mendimet e mia në krahasim me mendimet tuaja!”.

Ati, në Jezusin, na i ka zbuluar haptazi udhët dhe mendimet e veta, duke treguar kështu kuptimin e dinamikave të krijimit. Në Të qielli është bërë tokë, për ta bërë tokën pjesë të qiellit. Mendimet e Hyjit janë mëshirë dhe dashuri; udha e Tij është mishërimi. Fjala sot na fton që t'i përqafojmë udhët e mendimet e Hyjit tonë, duke iu përgjigjur në jetën tonë bujarisë dhe përkujdesjes së Tij falas për tokën.

Nëse punëtorët e parë merren vesh me zotërinë e vreshtit për pagesën ditore, punëtorët e fundit do të pranojnë të shkojnë duke i besuar thjeshtë thirrjes së tij: *“Shkoni edhe ju në vreshtin tim e do t'ju jap sa të jetë e drejtë”*. A mos ndoshta pagesa e punëtorëve të orës së fundit vlen më pak, sesa ajo e orëve të para? Por pikërisht falë punës së tyre puna përfundon! Jezusi ka zgjedhur që të jetë njëri prej “të fundmëve”: bën vullnesën e Atit me besim dhe realizon kështu veprën e shpëtimit. Çfarë vendi kanë këta “të fundit” në bashkësitë tona?

DOM GRAZIANO GAVIOLI
(FAMULLITAR DHE BARITORJA E EMIGRANTËVE)

E diela e IV

Ez 18, 25-28; Ps 24 (Të të bien në mend mëshirat e tua, o Zot); Fil 2, 1-11; Mt 21, 28-32

Tema e mëshirës është themelore për ta kuptuar drejtësinë e Hyjit. Nuk mund ta ndajmë drejtësinë prej mëshirës në jetën tonë të përditshme, në marrëdhëniet e ndërsjella dhe në marrëdhënien tonë me Hyjin, në respektin tonë ndaj Krijimit të Hyjit. Dashuria që Hyji ka për njerëzit bën që ta tejkalojmë padrejtësinë, vetëm nëse dimë ta njohim atë dhe nëse kemi forcën që ta tejkalojmë udhën që na çon drejt vdekjes, e cila është më e lehtë, më e gjerë, në krahasim me udhën e ngushtë që na çon drejt jetës.

Një gjë e tillë kërkon që dashuria të banojë në ne. Përvoja e thellë e dashurisë së Hyjit bëhet masa e krahasimit, me qëllim që kjo dashuri në fe, të zhvillojë te secili prej nesh aftësinë për të qenë shenjtër për Krishtin. Të ecësh drejt shenjtërisë do të thotë të bësh vullnesën e Atit dhe të bësh një rrugëtim kthimi, ndryshimi mendësie, të jesh i aftë të besosh përtej çdo plani njerëzor, për të kuptuar forcën e dashurisë hyjnore, që jep në gjithçka dhe për gjithçka gëzim e ngushëllim. Nëse i kemi kushtuar pak kujdes Krijimit të Hyjit, atëherë është koha që të pendohemi dhe të besojmë. Mëshira atëherë do të jetë drejtësi dhe dashuri.

ARKIMANDRITI ATHENAGORAS FASIOLO
(ARQIDIOQEZA ORTODOKSE E ITALISË DHE E MALTËS)